# REPUBLIKA E SHQIPERISE
# AGJENCIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

# DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR SHËRBIME KONSULENCE PER PRIVATIZIMIN E PAKETES SE AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE “ALBTELECOM” Sh.A
# ME FOND LIMIT 25 000 000 (NJEZETEPESEMILIONE) LEKE PA TVSH

**PASQYRA E LËNDËS**

1. NJOFTIMI I KONTRATËS
2. KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI ……………………......................................
3. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROCEDURËN..........................................
4. UDHËZIME PËR KANDIDATËT /OFERTUESIT........................................................
5. FAZA I – PARAKULIFIKIMI (LISTA SHKURTËR)……………………….................
6. FAZA II - DORËZIMI DHE VLERËSIMI I PROPOZIMEVE ……………………….
7. VLERËSIMI I PROPOZIMEVE
**…………………………………………………………**
8. ANKIMI ADMINISTRATIV, NË DISPOZICION TË OFERTUESVE
9. NËNSHKRIMI I KONTRATËS.................................................................................. …
10. INFORMACION MBI DOKUMENTACIONIN E OFERTËS.....................................
11.
SHTOJCAT...............................................................................................................

# NJOFTIMI I KONTRATËS

## Seksioni I Autoriteti Kontraktor

### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri | Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes |
| Adresa | Blvd "Deshmoret e Kombit"1001 Tirane |
| Tel/Fax | ++ 355 42 223119 |
| E-mail | postmaster@mete.gov.al |
| Adresa e Internetit | www.mete.gov.al |

### I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

| | |
|---|---|
| Emri | Teuta Balili<br>Sonila Malko<br>Dhurata Hoxha |
| Adresa | Blvd "Deshmoret e Kombit"1001 Tirane |
| Tel/Fax | ++355 42 223119 |
| E-mail | tbalili@mete.gov.al; smalko@mete.gov.al; dhhoxha@mete.gov.al |

### I.3 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

| | |
|---|---|
| Institucion qëndror<br>**X** | Institucion i pavarur |
| Njesi te qeverisjes vendore | Tjetër |

## Seksioni II Objekti i kontratës

### II.1 Lloji i Kontratës

| Punë | Shërbime | Mallra |
|---|---|---|
| | **X** | |

**Lloji i "Kontratave për punë publike"**

| Realizimi i puneve | Projektimi dhe realizimi i puneve |
|---|---|

**Lloji i 'Kontratave Publike për Shërbime'**

Konkurs Projektimi Shërbime Konsulence Shërbime të tjera

X

**Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"**

Blerje Qira Leasing Blerje me këste Një kombinim i tyre

**II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1. Fondi limit 25.000.000 LEKE PA TVSH.

2. (Qellimi i kontratës, sasite)

   METE po kerkon nje keshilltar financiar, per te asistuar procesin e privatizimit te paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime Albtelecom, bazuar ne Detyrat Specifike (kapitulli C dhe D i Termave te References)

**II. 3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj 4 (kater),** duke filluar nga data e nenshkrimit te kontrates

**II.4 Vendndodhja e objektit te kontratës:**

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Tirane, Shqiperi

**II.5 Ndarja në LOTE:**

Po Jo X

**Nese po**

**II.6 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Sasia ose objekti dhe fondi limit i LOTEVE)

1______________________________________________________________________________

2.______________________________________________________________________________

3.______________________________________________________________________________

Etj.

**II.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme*(nëse ka):*

ose: nga në

**II.8 Do të pranohen variantet:**

Po Jo
X

**II.9 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër**

Po Jo **X**

## Seksioni III Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

**III.1 Kerkesat per kualifikim (*lista e shkurtër*)**

**III.1.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, duke përfshirë kërkesat lidhur me regjistrimin në regjistrat profesionalë ose tregtarë:**

Ofertuesi duhet të krijojë identitetin e tij ligjor dhe të provojë se ka të gjitha liçensat e kërkuara për kryerjen e ketij prokurimi.Per kete ai duhet te paraqese:

a) Dokumentat e regjistrimit si Person Juridik.
b) Liçensa (t) e kërkuar eshte/janë: Ofertuesi konkurent duhet te jete i liçensuar ne fushat perkatese te konsulences sipas termave te references.

Kerkesat per kualifikim jane njesoj te zbatueshme per konsulentin, si person fizik, ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh, ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës, për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të realizuar mënyra më të mira, dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike e çastit, ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur

**III.1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit te prokurimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë siç parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe te veçanta të Kontratës.

Dokumentat që provojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë te pakten dy referenca nga institucione financiare (banka ose institucione financiare) per kredibilitetin e shoqerise ne vleren jo me pak se 10% te fondit limit qe do te prokurohet.

**III.1.3 Kapaciteti teknik:**

- Te jete nje kompani konsulente ose bashkim kompanish, me reputacion nderkombetar;
- Te kete eksperience ne asistimin e procedurave te privatizimit, duke perfshire edhe fushen e ekspertizes ligjore dhe financiare;

- Te kete eksperience ne vleresimin e bizneseve, veçanerisht ne sektorin e telekomunikacioneve;
- Te kete ekperience ne tregun nderkombetar te telekomunikacioneve ne pergjithesi.

Per te percaktuar aftesite dhe eksperiencen e kompanive te interesuara, informacioni i paraqitur duhet te perfshije :

a) emrin e kompanise, adresen, profilin,organizimin dhe stafin;
b) detaje te zyrave shqiptare te kompanise ose prezences ne Shqiperi, nese ka;
c) detaje te eksperiences se ndermarrjes se detyrave te ngjashme ne 5 (pese) vitet te meparshme, duke perfshire vendosjen dhe fokusimin ne rolin e kompanise ne vende te ngjashme te Europes Lindore;
d) CV e stafit qe mund te jete i mundshem te punoje ne detyre.

**III.2 Sigurimi i ofertes: (*vetëm në fazën e kerkeses*)**

2% (dy) i vleres se fondit limit qe prokurohet dhe do te kerkohet vetem ne fazen e kerkeses per propozim

## Seksioni IV <u>Procedura</u>

**IV.1 Lloji i procedurës:**

| E hapur | E kufizuar | Me negocim | Konkurs projektimi | Sherbime konsulence |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**Oferta më e mirë bazuar në:**

Çmimi **X** Propozimi teknik **X**

**IV.3 Afati kohor për dorëzimin e kërkesë për shprehje interesi :**

Data: **10/08/2009** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 10:00**

Vendi: www.app.gov.al

**IV.4 Afati kohor për hapjen e kërkesës për shprehje interesi :**

Data: **10/08/2009** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 10:00**

Vendi:. : www.app.gov.al

**IV.5 Periudha e vlefshmërisë së propozimit: 150 dite**

**IV.6 Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehejs së interesit:**

Shqip **X** Anglish
Tjetër ______________

**Seksioni V** **Informacione plotësuese**

**V.1 Dokumenta me pagesë:**

Po Jo

*Nëse Po*

Monedha ________ Çmimi ______

**V.2 Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktor: 6029099**

**V.3 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë** *(nëse zbatohet)***:**

Buletini i Njoftimeve Publike Data ________ Numri ______

**V.4 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

www.app.gov.al

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **27/07/2009**

## 2. KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Numri i Referencës, dhënë nga autoriteti kontraktor **6029099**

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE) ka programuar procesin e privatizimit te paketes se aksioneve, te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime Albtelecom sh.a , bazuar ne strategjine e privatizimit, miratuar me ligjin nr. 8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe ne Ligjin nr. Nr. 8810, date date 17.05.2001 "Për percaktimin e formes dhe te struktures se formules se privatizimit te shoqerise anonime "Albtelecom" .

Ne zbatim te Ligjit per privatizimin e Albtelecom, jane miratuar VKM nr. 428, date 2.07.2004 "Per menyren e transferimit te paketes se aksioneve te mbetura te shoqerise anonime Albtelecom, pas transferimit te paketes tek investitoret strategjike, Albapost sh.a-ja, ish-pronaret e truallit dhe punonjesit e shoqerise anonime Albtelecom " dhe VKM nr. 145, date 11.02.2009 "Per transferimin e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti, ne "Albtelecom", sha-ne, Tirane", te cilet percaktojne qe kjo pakete te transferohet nepermjet ankandit publik, me asistence te nje shoqerie keshilluese nderkombetare.

### Përshkrim i Përgjithshëm i Procedurës të Prokurimit

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore:

### Faza 1 – Shprehja e interesit dhe Parakualifikimi (lista e shkurtër):

Kandidatët do të dorëzojnë kërkesë për shprehje interesi të paraqituar pranë Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë kërkesat për shprehje interesi të dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë kërkesat për t'u siguruar nëse kërkesat dhe dokumentacioni shoqërues plotësojnë kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim.

### Faza 2 – Paraqitja propozimeve:

Autoriteti Kontraktor dërgon një ftesë për të dorëzuar propozime, kandidatëve që plotësojnë kërkesat minimale kualifikuese të Autoritetit Kontraktor, pra ata që janë kualifikuar në Fazën 1 (Ofertuesit e përzgjedhur në listën e shkurtër).
Pas marrjes së propozimeve, Autoriteti Kontraktor i shqyrton ato për t'u siguruar se janë plotësuar kushtet për pjesëmarrje dhe se ofertat kualifikohen ne baze te kërkesave te përcaktuara në dokumentat e tenderit. Propozimet përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor. Ky i fundit ia akordon kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

### OPSION [në rastet e loteve]

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot] [të gjitha lotet] [disa lote]. Për cdo lot paraqitet një ofertë e vecantë.

…………………………………

Për tu ftuar në tender kandidatët duhet të plotësojnë minimalisht kërkesat e DT;

Dokumentacioni i plotë i tenderit mund të tërhiqet në adresën e mëposhtme: www.app.gov.al

OPSION [nëse parashikohen pagesa] pas pagimit të një vlere të parimbursueshme prej ……………….. Lek

Shprehjet e interesit duhet të paraqiten
www.app.gov.al

Përpara
…………………………………………………………………………………………………
[percaktoni datën dhe kohen e afatit përfundimtar]

**Kur kerkesa per shprehje interesi kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë kerkesen në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al**

Të gjithë Kandidatët do të informohen sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në cdo rast brënda 5 ditëve nga marrja e vendimit në lidhje më procesin e parakualifikimit pas dorëzimit të shprehjes së interesit.

Kandidatët e kualifikuar do të ftohen të dorëzojnë propozime.

Kontrata do t'i akordohet ofertuesit që ka dorëzuar propozimin më të mirë sipas kritereve që jepen në DT

## 3. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PROCEDURËN

3.1 Procedura e prokurimit publik do të kryhet në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ¨Për Prokurimin Publik¨, me Rregullat për Prokurimin Publik, miratuar me VKM nr.1, datë 10 .01.2007, dhe me këtë Dokumentacion Tenderi.

3.2 Çdo operator ekonomik ftohet të dorëzojë një kërkesë për pjesemarrje por vetëm ata operatorë ekonomik të kualifikuar do të ftohen të dorëzojnë një propozim. Kontrata do t'i akordohet atij Operatori Ekonomik që ka dorëzuar propozimin e vlerësuar si më i miri, bazuar në kriteret e përcaktuara në DT.

3.3 Në përputhje me Nenin 24 të LPP Autoriteti Kontraktor mund të anullojë procedurën e prokurimit për një nga arsyet e mëposhtme:

1) nuk është paraqitur asnjë kerkese per shprehje interesi brenda afateve kohore;
2) asnjë nga kerkesat/propozimet e paraqitura nuk pajtohet me kriteret;
3) të gjitha kerkesat/propozimet e pranuara përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
4) numri i kerkesave/propozimeve të pranueshme që janë paraqitur është më i vogël se 2 (dy) dhe nuk sigurohet konkurencë e mirëfilltë;
5) për arsye të tjera të vërtetueshme, jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e botimit të procedurës së prokurimit, në emër të interesit publik;
6) kur të gjitha kerkesat/propozimet e paraqitura rezultojnë anomalisht të ulta;

Të gjithë Operatorët Ekonomikë që kanë dorëzuar një kerkese per pjesmarrje/propozim ose kanë marrë pjesë në procedurë do të njoftohen për vendimin e marrë dhe arsyet për anullimin e procedures së prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

3.4 Termat e përdorur në Dokumentat e Tenderit kanë kuptimet e mëposhtme:

"Person(-a) i(të) Autorizuar" - person(a) të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor të veprojnë në emër të tij dhe person(a) të autorizuar me Prokurë të Posaçme, autorizim me shkrim ose me një mënyrë tjetër ligjore për të vepruar në emër të Ofertuesit.
"Autoriteti Kontraktor" – [Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes)
"LPP" - Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".
"Procedura e Prokurimit"– procedurë e kryer nga Autoriteti Kontraktor, bazuar në këtë Dokumentacion Tenderi.
"Rregullat e Prokurimit Publik" – Aktet nënligjore të nxjera në zbatim të LPP, që përfshin veç të tjerave, Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.1 datë 10 .01.2007.
"Operatorë Ekonomikë " – mund të jetë cdo person fizik ose juridik, ose çdo grup personash të tillë, që ofrojne kryerjen e sherbimeve.
"Kandidat" – eshte cdo operator ekonomik qe kerkon te ftohet ne nje procedure te kufizuar.
"Ofertues" – çdo operator ekonomik që ka paraqitur një ofertë, në pajtim me DT.

"DT" –Dokumentacion Tenderi.

## 4. UDHËZIME PËR OPERATORET EKONOMIKE

### Mënyrat e komunikimit me kandidatet/ofertuesit

4.1 I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kandidatit/Ofertuesit duhet të bëhet me shkrim, siç përcaktohet në Nenin 22 të LPP.

4.2 Në veçanti, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet ________ (psh, postë, faks, mjete elektronike (në adresë interneti të përmendur në seksionin I (2) të njoftimit te kontrates). Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj me shkrim sipas nenit 22 te LPP, ka mbërritur tek Autoriteti Kontraktor para skadimit të afatit kohor.

### Hartimi i kerkeses/Propozimit

4.3 Kandidatet/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kerkesat/propozimet, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Kerkesat/propozimet që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

4.4 Kandidatet/Ofertuesit perballojne kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e kerkeses/propozimit së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

4.5 Kerkesa/Propozimi dhe të gjithë dokumentat e korrespondenca që lidhet me kerkesen/propozimin, e shkëmbyer ndërmjet Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor duhet të përgatiten në gjuhën shqip (nëse është e zbatueshme). Materialet mbështetëse dhe literatura e printuar, që paraqitet nga Kandidati/Ofertuesi mund të jetë e shkruar edhe në një gjuhë tjetër që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, me kusht që këto dokumenta të shoqërohen me përkthimin e duhur në gjuhën e ofertës, të fragmenteve përkatëse.

4.6 *(opsion)*.
Një takim sqarues do të organizohet në _________ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me DT dhe vendin e kryerjes së shërbimit. Pjesmarrja është fakultative, por Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë parapraksisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë takimit do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime, të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomik. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me takimin duhet të mbulohen nga vetë ata.

Për të organizuar takimin ju lutem kontaktoni: (përcaktoni personin e kontaktit)

4.7 Origjinali i kërkesës/propozimit duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë qe nuk fshihet. Të gjitha fletët e kerkesës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e

propozimit, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/propozim duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar. Për më tepër, në rast të kërkesave/propozimeve të paraqitura nga një bashkim operatoresh ekonomike, oferte duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit (Prokura mund të përfshijë edhe autorizimin për të nënshkruar një kontratë).

## 5. FAZA I – PARAKUALIFIKIMI (Lista e shkurtër)

### Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e kërkesave për shprehje interesi

5.1 Afati kohor për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi skadon më 10.08.2009 ora 10:00
Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i kthehen Kandidatit të pahapura.
**Ne rastin e prokurimit elektronik afati kohor per dergimin e kerkeses per shprehje interesi skadon ne momentin e ores se percaktuar nga autoriteti kontraktor per dorezimin e kerkesave**

5.2 Kërkesat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:
www.app.gov.al
**Ne rastin e prokurimit elektronik, kerkesa per shprehje interesi do te dorezohet ne rruge elektronike ne faqen zyrtare te APP-se.**

5.3 Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetem kërkesën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Kandidatit dhe të shënuar:
"Kërkesë për parakualifikimin në procedurën Nr. Kontratës_______________
**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS. DHE JO PARA ____________ (dd/mm/vv), ______orë".**
**Ne rastin e prokurimit elektronik, kerkesa per shprehje interesi do te dorezohet ne rruge elektronike ne faqen zyrtare te APP-se.**

### Kushtet e Përgjithshme për pjesëmarrje dhe vërtetimet e kërkuara

5.4 Në përputhje me LPP, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kërkesat e tyre nuk duhet të refuzohen bazuar në nenin 45 të LPP;
b) ata duhet të gëzojnë të drejtën për të zhvilluar një aktivitet profesional dhe/ose për t'u regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose profesionalë;
c) gjendja e tyre ekonomike dhe financiare duhet të garantojë ekzekutimin e duhur të kontratës;
d) aftësia e tyre teknike e profesionale duhet të garantojë një ekzekutim të përshtatshëm të kontratës.

5.5 Në përputhje me Nenin 45 të LPP, kërkesa do të refuzohet nëse Operatori Ekonomik:

a) ka falimentuar ose po likujdon aktivitetin, ose ka hyrë në marrëveshje me kreditorët, ose ka pezulluar ose kufizuar aktivitetet e biznesit, ose është në një situatë të ngjashme, të shkaktuar nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve e rregulloreve përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
b) i është nënshtruar procedurave për deklarimin e falimentimit, për një urdhër të likujdimit të detyrueshëm ose për një marrëveshje me kreditorët, ose procedura të tjera të ngjashme, sipas ligjeve e rregullave përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
c) është dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen e tij/të saj profesionale ;
d) është gjykuar fajtor nga një gjykatë kompetente e Shqipërisë për sjellje të gabuar profesionale;
e) nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimit shoqëror, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
f) nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
g) keqinformon dhe dorëzon dokumenta, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi

5.6 Operatoret ekonomike duhet të jenë të regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor.

5.7 Operatorët Ekonomikë mund të vërtetojnë se nuk i përkasin asnjë prej rasteve të përmendura në seksionin 5.4 dhe 5.5 duke paraqitur evidencat e përshkruara në Shtojcën 6 të DT.

**Kriteret Specifike të Kualifikimit**

5.8 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: (*autoriteti kontraktor mund të vendosë një numër kërkesash me kusht që këto të jenë të sakta, objektive, jodiskriminuese dhe në përpjestim me natyrën e kontratës):*

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) **Nje kontrate per sherbime te meparshme te ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit;**
b) Liçensa/t profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës nëse egzistojnë:
____________________
____________________

5.9 Licenca profesionale dhe CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës (*për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*)

_________________

5.10 Vlerësimi i aftësive teknike e profesionale të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dëshmitë apo dokumentat e parashikuara në Shtojcën 6 të DT.

**Bashkimi i operatoreve ekonomike**

5.11 Kërkesat/propozimet mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë ekzekutimit të kontratës. Në kerkese duhet të përcaktohet pjesa e sherbimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

5.12 Para dorëzimit të kërkesës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht me anë të një marrëveshjeje të noterizuar, në të cilën tregohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes apo sherbimi konkrete qe do te realizohet për secilin anëtar, si dhe autorizimi/prokurën për përfaqësimin e anëtarëve të grupit, si për dorëzimin e propozimit ashtu edhe për lidhjen e kontratës në rast të shpalljes fitues. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen si bashkim të operatorëve ekonomikë

5.13 Në rastet e kërkesave të paraqitura nga një bashkim operatoresh ekonomike, gjatë vlerësimit të kërkesave të përcaktuara në DT, Autoriteti Kontraktor merr parasysh kualifikimet dhe aftësitë teknike e profesionale të këtij bashkimi të marrë së bashku. Dokumentat e permendur ne seksionet 4.2, 4.3 dhe 4.4 duhet të përgatiten veçmas për secilin anëtar të bashkimit dhe duhet t'i bashkangjiten ofertes. Nderkohe, kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithe grupi i marre se bashku, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, te percaktuara ne aktmarreveshje.

## 6. FAZA II - DORËZIMI DHE VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

Propozimet do të dorëzohen vetem nga kandidati që ka marrë nje kërkesë për propozim nga Autoriteti Kontraktor, sipas modelit të dhënë në Shtojcën 1.

### 6.1 Propozimi duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

Propozimi përbëhet nga propozimin teknik dhe propozimi ekonomik.

**Propozimi teknik përfshin**:

a) Përshkrim të detajuar të Shërbimeve të propozuara dhe metodologjinë e tyre, që përmbajnë gjithë informacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit, dhe që është i mjaftueshëm për Autoritetin Kontraktor, për të përcaktuar nëse Shërbimet e propozuara plotësojnë kërkesat e specifikuara në Termat e Referencës;
b) Listën dhe Curriculum Vitae të Personelit Kryesor;
c) Grafikun e Zbatimit;
d)Autorizim me shkrim për përfaqësim të Ofertuesit.
e) Propozimin alternativ teknik, nëse lejohet;
(*cdo dokument tjetër të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor*)

**Propozimi ekonomik**:

a) Formati i Strukturës së Çmimit (shtojca 4);

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një propozim.

**Fshehtësia**

6.2 Neni 25 i Ligjit përcakton se:
"Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave"
Autoriteti Kontraktor mendon se jo i gjithë informacioni i dorëzuar nga Ofertuesit do të jetë konfidencial. Një pjesë e informacionit, duke përfshirë edhe atë tregtar, financiar ose teknik do të jetë bërë tashmë publik ose do të bëhet publik në të ardhmen.
Autoriteti Kontraktor i kërkon Kandidatëve/Ofertuesve që në momentin kur dorëzojnë informacion pranë tij, të specifikojnë se cila pjesë e tij duhet të konsiderohet si e fshehtë, mbi ç'baza dhe për sa kohë duhet të ruhet si e tillë.Në asnjë rrethanë çmimet e ofertave nuk mund të konsiderohen si konfidenciale/të fshehta.
Ofertuesi duhet të rendisë (në formatin e përcaktuar si Shtojca 13), atë pjesë të informacionit që duhet të ruhet i fshehtë dhe arsyet për të.

6.3 Ofertuesit duhet të dorëzojnë vetem propozimin origjinal. Propozimi përbëhet nga zarfi i propozimit teknik dhe zarfi i propozimit ekonomik, të cilët identifikohen qartë duke bërë shënimet përkatëse.
Propozimi duhet të futet në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Propozim për shërbime konsulenece __________ ;
Nr Kontratës_______________
**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS DHE JO PARA ____________ (dd/mm/vv), ______orë".**

6.4 Ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin propozimet e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e propozimeve. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Seksioni 6.3 i DT udhëzon Ofertuesit lidhur edhe me modifikimin ose tërheqjen e propozimve të tyre. Rrjedhimisht, zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM PROPOZIMI "** ose **"TËRHEQJE PROPOZIMI ".**

**Llogaritja e çmimit**

6.5 Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Kandidati duhet të dorëzojë:
-Tarifa për njësinë e kohës për çdo person;
-Përmbledhje të kostove direkte dhe indirekte dhe shpenzimeve, duke përfshirë taksat, tarifat, tarifat e liçensave, siguracionin dhe kosto të tjera të lidhura me kryerjen e Shërbimeve;

-Çmimin total të propozimit pa TVSH; dhe vlerën e TVSH nëse është e aplikueshme.
- (*ndonjë informacion tjetër të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor*).

**Propozimet Alternative**

6.6 Nëse lejohet në Dokumentat e Tenderit, Ofertuesit mund të ofrojnë propozime alternative teknike për kërkesat e specifikuara në Dokumentat e Tenderit. Autoriteti Kontraktor mund të shqyrtojë vetëm alternativat teknike, nëse ka të tilla, të atij ofertuesi që ka paraqitur propozimin fitues, në pajtim me të gjitha kërkesat e DT.

6.7 Nëse kërkohet në Dokumentat e Tenderit, secili ofertues duhet të paraqesë sëbashku me propozimin kryesor, një propozim të veçantë për shërbime të caktuara, të përshkruara në Dokumentat e Tenderit të cilat Ofertuesi mund t'i përfshijë ose jo në kontratë. Këto propozime të veçanta quhen "propozime alternative/të mundshme". Përzgjedhja e propozimit fitues do të marrë në konsideratë propozimet alternative/të mundshme, vetëm nëse një gjë e tillë lejohet specifikisht në Dokumentat e Propozimit.

**Sigurimi i ofertës**

6.8 Që një Ofertues të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 5. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _________ Lekë (shuma e shprehur në fjalë:______).

(OPSIONALE: nëse Autoriteti Kontraktor e ndan objektin e prokurimit publik në Lote)
Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:
Loti 1 ______ Lekë
Loti 2 ______ Lekë

6.9 Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashke me oferten para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertes.

6.10 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a garanci bankare e pakushtëzuar,
b garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet bashke me oferten para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

6.11 Dokumentat e përmendur në germat a) – b) te pikes 6.10 duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

**Periudha e Vlefshmërisë së Kerkeses/Propozimit**

6.12 Kerkesat/propozimet duhet të jenë të vlefshme për 150 (dite) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e kerkesave/propozimeve. Periudha e vlefshmërisë së ofertave fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e kerkesave/propozimeve. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor me shkrim, duhet të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të paraqesë një sigurim oferte të zgjatur. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk arrin t'i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk bën zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, ose nuk arrin të paraqesë një sigurim të zgjatur të ofertës, atëherë do të konsiderohet se Ofertuesi e ka refuzuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor. Në këtë rast Autoriteti Kontraktor do të refuzojë kerkesen/propozimin.

**Nënkontraktimi (opsion)**

6.13 Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin, për realizimin e një pjese të kontratës. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40 % të vlerës së kontratës dhe mund të kufizohet në sherbime të veçanta. Ofertuesi duhet të deklarojë nënkontraktorin e përzgjedhur gjatë deklarimit të ofertës. Nënkontraktori i përzgjedhur duhet të zotërojë kulifikimet e nevojshme për ekzekutimin e nënkontratës të cilat verifikohen nga Autoriteti Kontraktor përpara lidhjes së nenkontratës.

**Veprimet e jashtëligjshme**

6.14 Në përputhje me Nenin 26 të LPP, me legjislacion për parandalimin e konfliktin e interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktor e refuzon një ofertë, nëse ofertuesi që e ka paraqitur atë:

a) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktor një dhuratë në kesh ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së prokurimit publik; dhe/ose

b) është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues eshte i lidhur me nje person fizik ose juridik qe eshte ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me prokurimin, apo ka lidhje me anëtarë të komisionit të vlerësimit etj.

c) ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Seksionin 5 të DT.

6.15 Autoriteti Kontraktor e informon me shkrim Ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e kërkesës ose propozimit, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e prokurimit.

## 7. VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

### Vlerësimi i Propozimeve Teknike

7.1 Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

### Hapja e Propozimeve Financiare

7.2 Pas përfundimit të vlerësimit të propozimeve teknike, Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesit, propozimet e të cilëve janë refuzuar, pasi nuk kanë plotësuar disa aspekte të rëndësishme të Kërkesave, ose nuk kanë arritur të marrin rezultatin minimal, nëse ky është parashikuar. Njëkohësisht, Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftimin për ditën dhe orën e hapjes së propozimeve ekonomike të gjithë kandidatëve, propozimet ekonomike të të cilëve do të hapen. Në datën dhe orën e përcaktuar, Autoriteti Kontraktor hap propozimet ekonomike. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e propozimeve. Zarfi ku shkruhet “Propozimi Ekonomik” për secilin propozim që nuk është refuzuar më parë, do të hapet dhe informacioni i mëposhtëm do të shpallet e regjistrohet: emri i Ofertuesit, rezultati i vlerësimit të propozimit teknik, Çmimi i propozuar, siç shprehet në propozimin ekonomik.

### Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike

7.3 Autoriteti Kontraktor përcakton nëse propozimet ekonomike janë të plota, korrigjon ndonjë gabim aritmetik dhe për qëllime krahasimi e vlerësimi, i konverton të gjitha çmimet e propozimit në një monedhë të vetme. Autoriteti Kontraktor rendit dhe cakton një rezultat për çdo propozim ekonomik.

### Krahasimi i Propozimeve

7.4 Autoriteti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata dhe për lidhjen e kontratës.

### Kriteret e vlerësimit

7.5 Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

| | Kriteret e Vleresimit | Pikët |
|---|---|---|
| (i) | Përvoja per Pune te Ngjashme te Konsulentit | [10] |

(ii) Metodologjia e Propozuar [50]
(Përqasja teknike dhe metodollogjia, plani i punës, aftësia organizative)

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [30]

(iv) Transferimin e Njohurive, (*nëse kërkohet*) [10]

**Total (Propozimi Teknik) 100%**

**Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, per te vazhduar me vleresimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formules se mëposhtme:

Pe- Piket per Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi me i Ulet i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhes *(duke filluar nga cmimi me i ulet)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(cmimi me i ulet = piket maksimale per propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat per Propozimet Teknike dhe Financiare jane dhene si me poshte:

**Pesha per Propozimin Teknik: X = (piket e propozimit teknik x 0.8)**

**Pesha per Propozimin Ekonomik: Y = (piket e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta me e mire do te jete sipas kombinimit te pikeve te propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes eshte si me poshte:

**Oferta me e mire = X + Y**

Firma qe ka marre me shume pike gjate mbledhjes se pikeve teknike dhe ekonomike do te ftohet per negociata dhe lidhjen e kontrates.

## Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

7.6 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në kerkese/propozim, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të kerkesave/propozimeve. Autoriteti Kontraktor e pajis menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t’a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të

pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë kerkesa/propozimi do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

7.7 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:

a) në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,

b) përveç kontratave me shuma të mëdha, nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total,

c) nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet.

7.8 Autoriteti Kontraktor e konsideron një kerkese/propozim si të pranueshme, nëse ajo i plotëson kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në DT. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'a quajë kerkesen/propozimin të pranueshme, nëse:

a) ajo përmban ndonjë gabim ose pakujdesi që mund të korrigjohen pa ndryshuar asnjë kusht ose aspekt material të kësaj kerkese/propozimi, ose që nuk ndikojnë në konkurencë, ose

b) ajo përmban vetëm devijime të vogla që nuk e ndryshojnë materialisht ose që nuk lindin si pasojë e karakteristikave, kushteve dhe kërkesave të tjera të paraqitura në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit; megjithatë, me kusht që çdo ndryshim i tillë të matet sa më mirë të jetë e mundur, dhe të merret në konsideratë siç duhet gjatë vlerësimit dhe krahasimit të kerkesave/propozimeve.

7.9 Sa herë që refuzohet një kerkese/propozim ose s'kualifikohet një ofertues, autoriteti kontraktor informon ofertuesin e interesuar mbi arsyen/t e s'kualifikimit ose refuzimit. Formulari i njoftimit gjendet në Shtojcën 7 të DT.

## 8. ANKIMI ADMINISTRATIV NE DISPOZICION TE KANDIDATEVE/OFERTUESVE

8.1 Çdo operator ekonomik që ka një interes ligjor në kontratat e prokurimit publik dhe beson se Autoriteti Kontraktor ka shkelur dispozitat e LPP dhe rregullat për PP gjatë procedurës në fjalë të shpalljes së kontratës fituese, ka të drejtë të kundërshtojë këtë procedurë. Gjatë bërjes së ankesës, pala e interesuar duhet të përdorë formularin e ankesës, që gjendet në Shtojcën 14 të DT.

8.2 Kundërshtimet duhet t'i paraqiten me shkrim Autoritetit Kontraktor brenda 5(pesë) ditëve nga dita kur ankimuesi ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për shkeljen e pretenduar.

8.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të shqyrtojë këtë kundërshtim brenda afateve limit kohorë të specifikuar në nenin 63 të LPP, ose e refuzon kundërshtimin, atëherë ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Agjencisë së Prokurimit brenda 5 (pesë) ditëve pune që nga dita e parë e punës pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në seksionin 8.2, ose, nëse kundërshtimi refuzohet në shkallë të parë nga Autoriteti Kontraktor, që nga dita kur ankimuesi u informua nga Autoriteti Kontraktor për sa më sipër. Një kopje e këtij ankimi me shkrim duhet t'i njoftohet njëherazi edhe Autoritetit Kontraktor. Ankimuesi duhet të përdorë të njëjtin formular standard për ankimimin, siç parashikohet në seksionin 8.1. Formulari mund të shkarkohet pa kosto edhe në faqen e internetit të APP, www.app.gov.al.
Ankesat duhet t'i drejtohen personit/zyrës
Z. Durim Kraja, ++ 355 42 222245/74107
E-mail : dkraja@mete.gov.al

8.4 Njëherazi, nëse dëshirohet një gjë e tillë, pala e interesuar mund të dorëzojë një kopje të ankesës drejtpërdrejt pranë Zyrës së Avokatit për Prokurimet Publike.

## 9. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

9.1 Autoriteti Kontraktor e informon atë Ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të njoftimit të shpalljes fitues, siç parashikohet në Shtojcën 7. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP.

**Sigurimi për ekzekutimin e kontratës**
**(OPSION)**

9.2 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 13 e DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

9.3 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
a) garanci bankare e pakushtëzuar,
b) garanci sigurimi,

9.4 Në pajtim me Rregullat për PP, pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor dërgon një njoftim në APP për Publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**Kushtet e kontratës**

9.5 Autoriteti Kontraktor do të firmosë me atë Ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si oferta me e mire bazuar ne kriteret e perzgjedhjes për kontratën e [_____] [për një Lot të caktuar], ___________.

9.6 Drafti i kontratës përfshihet si Shtojca 8 dhe Shtojca 9 e këtij Dokumentacioni Tenderi ("Drafti"). Ofertuesi duhet të plotësojë Draftin me të dhënat dhe detajet e tij, që gjenden në kerkese/propozim (psh, çmimi).

9.7 Drafti i Kontratës (kushtet e vecanta dhe të përgjithshme), në rast të shpalljes fitues, plotësohet nga Ofertuesi duke e firmosur në çdo faqe të tij nga Personat e Autorizuar. Në Formularin e Deklarimit të Propozimit, Ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës ,(shtojcat 8 dhe 9).

## 10. INFORMACION MBI DOKUMENTACIONIN E TENDERIT

10.1 Tarifa për DT është _________lekë. Kjo tarifë mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatoret Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

10.2 Operatorët ekonomikë mund te ankimojne ose të kërkojnë sqarime me shkrim të DT nga Autoriteti Kontraktor, në kohë të përshtatshme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë para datës së fundit për dorëzimin e kerkesave.

10.3 Autoriteti Kontraktor përgatit një përgjigje me shkrim, duke ruajtur parimet themelore të konkurencës për procedurën e prokurimit, që duhet t'i shpërndahet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve, jo më vonë se 3 (tre) ditë pas marrjes së kërkesës. Nëse përgjigjia mund të kërkojë ndryshime në DT, atëherë Autoriteti Kontraktor, sipas Nenit 42 të LPP, e zgjat afatin kohor të LPP për dorëzimin e ofertës, me 5 dite per prokurimet me vlere nen kufijte e larte monetare monetare dhe me 10 dite per prokurimet me vlere mbi kufijte e larte monetare, ne perputhje me nenin 42 te LPP-se se ndryshuar.

10.4 Autoriteti Kontraktor mund të ndryshojë në çdo kohë Dokumentacionin e Tenderit, me kusht që të gjitha ndryshimet t'i vihen në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar në të njëjtën ditë dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së përcaktuar si afati limit për dorëzimin e kerkesave. Çdo ndryshim i kryer do të jetë pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Tenderit.

**Shenim:** Autoritetet kontraktore nuk duhet te nderhyjne per te bere asnje lloj plotesimi ose ndryshimi ne dokumentat e tenderit nga pika 2 ne piken 8. Te gjitha plotesimet do te behen tek shtojcat.

## 11. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Kërkesa për Propozim
Shtojca 2: Formulari I Dorezimit te Kerkeses/Propozimit
Shtojca 3 Formulari i Deklarimit të Propozimit
Shtojca 4: Formati i Propozimit Ekonomik

Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 6: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 7: Formulari i Njoftimi të Fituesit
Shtojca 8: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 9: Kushtet e Vecanta të Kontratës
Shtojca 10: Formulari i Kontrates
Shtojca 11: Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës
Shtojca 12: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 13: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 14: Formulari i Ankesës për Prokurimin
Shtojca 15: Specifikimet teknike
Shtojca 16: Volumi i shërbimeve, dhe kushtet e lëvrimit
Shtojca 17: Termat e References
Shtojca 18: Kerkesa per personelin kryesor
Shtojca 19 Deklarata per konflikt interesi

**Shtojca 1.**

[AUTORITETI KONTRAKTOR]

**KËRKESË PËR PROPOZIM**

*(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për shprehje interesi)*

[Ref. …] [Data]

Për : *[Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]*

Emri ________________________________________

Adresa ________________________________________

Tel/Fax ____________________________________

E-mail ____________________________________

**Procedura e Prokurimit**: ____________________________

**Përshkrim i Shkurtër i Kontratës**:*(natyra e kontratës dhe fondi limit)*

______________________________________________________________

________________________________________________________

_____________________________________________________________

**KOHËZGJATJA E KONTRATËS OSE KOHA LIMIT PËR PËRFUNDIMIN E SAJ**

**Fillon më** / / dhe/ose **mbaron më** / / (dd/mm/vvvv)

Publikim i mëparshëm *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se *[emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur]*, pas vlerësimit të kapaciteteve tuaja ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, kërkesa juaj për pjesëmarrje është pranuar në fazën e ofertimit në këtë procedurë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[këtij autoriteti kontraktor]*

Emri ________________________________________

Adresa ________________________________________

Tel/Fax ________________________________________

E-mail ________________________________________

Adresa në Internet ________________________________________

në emër të

*(emri dhe adresa e personit përgjegjës)*

Emri ________________________________________

Adresa ________________________________________

Tel/Fax ________________________________________

E-mail ________________________________________

Adresa në Internet ________________________________________

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin e propozimit është :**

**Data, ora dhe adresa**

Data / / *(dd/mm/vvvv)* Ora: ________________________

Adresa ____________________________________________________________

**Afati kohor për hapjen e propozimeve është:**

**Data, ora dhe adresa**

Data / / *(dd/mm/vvvv)* Ora: ________________________

Adresa ____________________________________________________________

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :**

Autoriteti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata dhe për lidhjen e kontratës. (shih seksionin 7 të DT)

**Informacione apo kerkesa shtesë** (të *plotësohet nga Autoriteti Kontraktor*)

Periudha e vlefshmërisë së ofertës (propozimit) është [*numri i ditëve*];

Në përgatitjen e propozimit duhet të ndiqni kushtet dhe udhëzimet e dhëna në dokumentat e tenderit.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

**Shtojca 2**

**FORMULARI I DORËZIMIT TË KERKESES/PROPOZIMIT**

Titulli i kontratës dhe numri i referencës: ____________________

Njoftimi i Kontratës: __________________________________

(Vendi dhe Data)

PËR: *(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)*
________________________________________________________________________

DORËZUAR NGA
**Emri (-at) e ofertuesit (-esve) Firma**
**Përfaqësuesi ***
**Partneri 2***
**Etj … ***

* shto/fshi rreshta të tjerë për partnerë, nëse nevojitet. Vini re se nënkontraktori nuk konsiderohet partner në këtë procedurë tenderi. Nëse kjo ofertë dorëzohet nga një ofertues individual, atëherë emri i tij duhet të regjistrohet si '**drejtues** (dhe të gjithë rreshtat e tjerë duhet të fshihen)

**Nr. i fleteve te dorezuara _______ (flete)**

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**
**Emri:**
**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**
**Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 3**

[*Letër me kokë e ofertuesit*]

## FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

*[Ref. ______]*
*[Data______]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Procedura e prokurimit *(nëse zbatohet)*: *[referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit kontraktor]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[lloji i procedurës dhe objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

1 Kemi shqyrtuar Dokumentat e kesaj procedure **dhe** paraqesim këtë Propozim, **pa rezervime ose përjashtime** për kërkesat ose afatet dhe kushtet e shprehura këtu.

2. Ne ofrojmë të kryejmë Shërbimet siç specifikohet në Dokumentat e kesaj procedure dhe në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
3. Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.
4. Propozimi ynë do të jetë i vlefshëm për periudhën e specifikuar në DT.
5. Nëse propozimi ynë pranohet, ne do te bejme sigurimin e kontrates, siç parashikohet ne DT.
6. Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë prokurim.
7. Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentet, që i bashkëlidhen kesaj oferte.
8. Pajtohem per te firmosur kontraten sipas formularit te kushteve te kontrates nese shpallem fitues.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

**Shtojca 4**

**STRUKTURA E PROPOZIMIT EKONOMIK**

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës :** **(**Nentotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** **(**Nentotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** **(**Nentotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** **(**Nentotali i detajuar)

**TOTALI**

**Shtojca 5.**

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

[Ref.________]
[Data _______]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *(nëse zbatohet)*: *[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[lloji i procedurës dhe objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,
Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e kerkeses, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

a) Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar kerkesen, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e kerkesave ose para afatit perfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
b) Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille;
c) Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, kur propozimi eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 6.**

## KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga. Qendra Kombetare e Regjistrimit
2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, lëshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.
3. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, lëshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.
4. Një dokument që vërteton se kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqsor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit.
5. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore.
6. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1-6) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në te cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, per kete ato kandidatë duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për të vërtëtuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar në përputhje me seksionin 4 të DT, ofertuesi duhet të paraqesë:(*të plotësohet nga autoriteti kontraktor, në pajtim me kërkesat e parashikuara në Seksionin 4 të DT)*

Ofertuesi duhet të krijojë identitetin e tij ligjor dhe të provojë se ka të gjitha liçensat e kërkuara për kryerjen e ketij prokurimi.Per kete ai duhet te paraqese:

c) Dokumentat e regjistrimit si Person Juridik.
d) Liçensa (t) e kërkuar eshte/janë: Ofertuesi konkurent duhet te jete i liçensuar ne fushat perkatese te konsulences sipas termave te references.

Kerkesat per kualifikim jane njesoj te zbatueshme per konsulentin, si person fizik, ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh, ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës, për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të realizuar mënyra më të mira, dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike e çastit, ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur

### III.1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit te prokurimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë siç parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe te veçanta të Kontratës.

Dokumentat që provojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë te pakten dy referenca nga institucione financiare (banka ose institucione financiare) per kredibilitetin e shoqerise ne vleren jo me pak se 10% te fondit limit qe do te prokurohet.

### III.1.3 Kapaciteti teknik:

- Te jete nje kompani konsulente ose bashkim kompanish, me reputacion nderkombetar;
- Te kete eksperience ne asistimin e procedurave te privatizimit, duke perfshire edhe fushen e ekspertizes ligjore dhe financiare;
- Te kete eksperience ne vleresimin e bizneseve, veçanerisht ne sektorin e telekomunikacioneve;
- Te kete ekperience ne tregun nderkombetar te telekomunikacioneve ne pergjithesi.

Per te percaktuar aftesite dhe eksperiencen e kompanive te interesuara, informacioni i paraqitur duhet te perfshije :

a. emrin e kompanise, adresen, profilin,organizimin dhe stafin;
b. detaje te zyrave shqiptare te kompanise ose prezences ne Shqiperi, nese ka;
c. detaje te eksperiences se ndermarrjes se detyrave te ngjashme ne 5 (pese) vitet te meparshme, duke perfshire vendosjen dhe fokusimin ne rolin e kompanise ne vende te ngjashme te Europes Lindore;
d. CV e stafit qe mund te jete i mundshem te punoje ne detyre.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 7.**

[Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMI TE FITUESIT**

[Ref. ________]
[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*
Procedura e prokurimit: *[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ___________________________________
*(me numra dhe fjale)*

2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ___________________________________
*(me numra dhe fjale)*

Etj._________________________________________________

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:
_____________________________________________________________________________
______________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike *[data] [numri]*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ____________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë __________________________

[Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor]

**Shtojca 8**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES
## Shërbimet e Konsulencës

### Neni 1 Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Shërbimeve të Konsulencës.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2 Përkufizime

2.1 "Kontratë" do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

3.1 Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.

4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 18 Forca Madhore

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

## Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## Neni 26 Nënkontrata

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

## Neni 27 Transferimi i të Drejtave

27.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

## Neni 28 Sigurimi i Kontrates

28.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japi Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anullimin e kontratës dhe konfiskimin e sigurimit të ofertes së Kontraktuesit.

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqesimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Shtojca 9**

## KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES
## Shërbimet e Konsulencës

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne ato te Kushteve te veçanta te kontrates.

**Neni 1 Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

1.2 Kontraktuesi është ______________________________________________________

**Neni 2 Sigurimi i kontrates**

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10 % te vleres se kontrates) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

______________________________________________________________________

**Neni 3 Fillimi i Kontrates**

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të filloje më __________. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

4.1 Shërbimet do të kryhen në: Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

**Neni 5 Informacion që Duhet Dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

**5.1** Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

**5.2 Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: ______________________________________________

**Neni 7 Siguracioni i Përgjegjsisë Profesionale**

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të siguroje Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale me shumë minimale si vijon: ______

______________________________________________________________________

## Neni 8 Kushtet e Pagesës

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marreveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

## Neni 9 Pagesa Paraprake

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: ____________________________________________
______________________________________________________________________

## Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 10.**

## FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: Sherbime konsulence
Nr. i Referencës së Kontratës: _________________________

Kjo Kontratë është lidhur më [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Sherbimeve, duke i'u referuar Prokurimit nr.___________________________________

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të realizojë Sherbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- këtë Formular Kontrate
- Formularin e Deklarimit te Propozimit, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
- Formulari i Propozimit ekonomik
- Grafiku i Ekzekutimit dhe Specifikimet Teknike
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Formulari i Njoftimit te Fituesit
- Formularin e Sigurimit të Kontratës
- Termat e References

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej ______________________________________________për realizimin e Sherbimeve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: ________________ ____________ dhe në formën e:_______________________________________ _____________, në ose përpara datës së shprehur në Formularin e Njoftimit te Fituesit.

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Sherbimet për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Sherbimet, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë ___/ ___/___/ palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

| Autoriteti Kontraktor | Kontraktuesi |
| --- | --- |
| ______________________________ | ______________________________ |
| ______________________________ | ______________________________ |
| Emri dhe firma e Përfaqësuesit | Emri dhe firma e Përfaqësuesit |
| Vula: | Vula: |
| Adresa:<br>Tel: | Adresa:<br>Tel: |

**Shtojca 11.**

## FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR

## Seksioni I Autoriteti Kontraktor

### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri ___________________________________________

Adresa ___________________________________________

Tel/Fax ___________________________________________

E-mail ___________________________________________

Adresa në Internet ___________________________________________

### I.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qëndror Institucion i Pavarur

Njesi e qeverisjes vendore Tjetër

## Seksioni II Objekti i Kontratës

### II.1 Lloji i Kontratës

Punë Shërbime Mallra

**Lloji i "Kontratave për Punë publike"**

Realizimi i puneve Projektimi dhe realizimi i puneve

**Lloji i 'Kontratave Publike për Shërbime'**

Konkurs Projektimi Shërbime Konsulence Shërbime të tjera

**Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"**

Blerje Qira Leasing Blerje me këste Një kombinim i tyre

### II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1 Fondi limit ___________________________________________________________________

2 Qellimi  i kontratës, sasite

_________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________

**II. 3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për realizimin:**

Kohëzgjatja në **muaj** **ose ditë**

ose

duke filluar nga / / me përfundim në / /

**II.4 Ndarja në LOTE:**

Po Jo

*Nëse Po,* numri i LOTEVE*:*

**II.5 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga në

**Seksioni III** **<u>Procedura</u>**

**III.1 Lloji i procedurës:**

E hapur | E kufizuar | Me negocim | Konkurs projektimi | Sherbim konsulence

*Në rast të procedurës me negocim:*

Justifikimi për përzgjedhjen e procedurës me negociim, pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës:

_________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________

**III.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**Oferta më e mirë bazuar në:**

Çmimi Propozimi teknik

**III.3 Numri i kerkesave të dorëzuara:** **Numri i kerkesave të rregullta:**

**III.3.1 Numri i propozimeve te dorezuara** **Numri i propozimeve te rregullta**

**III.4 Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktor:** ____________________

**Seksioni IV** **Informacion mbi kontratën**

**IV.1 Numri i Kontratës:** ______________ **Data e Kontratës**
/ /

**IV.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ______________________________________
Adresa ______________________________________
Tel/Fax ______________________________________
E-mail ______________________________________
Adresa e Internetit ______________________________________

**IV.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet dhe opsionet)*:

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha _________
Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha _________

**IV.4 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë** *(nëse zbatohet):*

Buletini i Njoftimeve Publike Data ________ Numri ______

**V.4 Informacione shtesë**

________________________________________________________________________
________________________________________________________________
________________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi / /

**Shtojca 12.**

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial.

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Shtojca 13.**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Ref. ________]
[Data ________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *(nëse zbatohet)*: *[referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit kontraktor]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[lloji i procedurës dhe objekti)]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.
Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 14.**

## FORMULARI I ANKESËS PËR PROKURIMIN

***Ankesë drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor*** ☐

***Ankesë drejtuar:*** ***Agjencia e Prokurimit Publik*** ☐

(*shënoni një nga kutitë*)

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

________________________________________

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

________________________________________

Adresa

| ____________ | ____________ | ____________ |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip |

| ____________________ | ____________________ |
|---|---|
| Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) |

________________________________________

E-mail

________________________________________

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

| ____________________ | ____________________ |
|---|---|
| Firma e zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |

| ____________________ | ____________________ |
|---|---|
| Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion për Procedurën**

1. **Numër Identifikimi**

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë* ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

________________________________________________

2. **Autoriteti Kontraktor**

*Emri i autoritetit që administron procesin e prokurimit.*

________________________________________________

3. **Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**

*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

________________________________________________

4. **Objekti i Kontratës**

*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

________________________________________________

5. **Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

6. **Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

________________________________________________

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza Ligjore e Ankesës**

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

________________________________________________

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

## Seksioni IV. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktor

*Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejpërdrejt autoritetit kontraktor. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.*

**1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (me shkrim, nepermjet faksit, etj.).**

**Po** ☐ **Jo** ☐

______________________________________________

**2. Autoriteti Kontraktor Pranë të Cilës është Bërë Kundërshtimi**

*Emri i autoritetit kontraktor.*

______________________________________________

*Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.*

______________________________________________

**3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese**

*Çfarë mase korrigjuese kërkoni?*

______________________________________________

**4. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.*

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

______________________________________________

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Agjencisë së Prokurimit Publik.**

Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit kontraktor.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

**Shtojca 15.**

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 16**

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **KONSULENCE PER PRIVATIZIMIN E E PAKETES SE AKSIONEVE TE ZOTERUARA NGA SHTETI NE SHOQERINE ANONIME ALBTELECOM**

Kontraktuesi, duhet te realizoje te gjitha sherbimet, sipas pershkrimit te dhene ne termat e references dhe pjesen tjeter te dokumentave te tenderit.

Ofertuesi duhet te paraqese si pjese perberese te ofertes:
- Metodologjine dhe planin e punes per realizimin e sherbimit te konsulences.
- Programin e detajuar te aktiviteteve per realizimin e sherbimit.

Afatet e ekzekutimit: Te perfundoje sherbimin e percaktuar ne kontrate, brenda 4 muajve nga dita e nenshkrimit te kontrates.

**Shtojca 17**

**TERMAT E REFERENCES**

**PER SHERBIMET E KONSULENCES PER PRIVATIZIMIN E PAKETES SE AKSIONEVE, TE ZOTERUARA NGA SHTETI NE SHOQERINE ANONIME ALBTELECOM SH.A.**

## A. Permbledhje

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE) ka programuar procesin e privatizimit te paketes se aksioneve, te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime Albtelecom sh.a (me poshte referuar si "Kompania"), bazuar ne strategjine e privatizimit, miratuar me ligjin nr. 8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe ne Ligjin nr. Nr. 8810, date date 17.05.2001 "Për percaktimin e formes dhe te struktures se formules se privatizimit te shoqerise anonime "Albtelecom" (më poshtë referuar si "Ligji i privatizimit të Albtelecom").

Ne zbatim te Ligjit per privatizimin e Albtelecom, jane miratuar VKM nr. 428, date 2.07.2004 "Per menyren e transferimit te paketes se aksioneve te mbetura te shoqerise anonime Albtelecom, pas transferimit te paketes tek investitoret strategjike, Albapost sh.a-ja, ish-pronaret e truallit dhe punonjesit e shoqerise anonime Albtelecom " dhe VKM nr. 145, date 11.02.2009 "Per transferimin e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti, ne ""Albtelecom", sha-ne, Tirane", te cilet percaktojne qe kjo pakete te transferohet nepermjet ankandit publik, me asistence te nje shoqerie keshilluese nderkombetare.

Albetelecom është një shoqëri aksionere e krijuar në 1999, me seli në Rrugen Myslym Shyri, no. 42, Tiranë, Shqipëri.

Albtelecom sh.a zoterohej teresisht nga Qeveria Shqiptare qe nga krijimi i saj deri ne Qershor 2007, kur Qeveria Shqiptare shiti 76 perqind te paketes se aksioneve te Albtelecom sh.a tek kompania turke CETEL Çalik Enerji Telekomünikasyon Hizmetleri A.S, (marreveshja e blerjes e Albtelecom sh.a, ratifikuar me Ligjin Nr.9785, date 19.07.2007). Aktualisht shteti shqiptar zoteron 16,7683661 perqind te paketes se aksioneve te Albtelecom sha-se.

Objekti i aktivitetit të shoqerise Albetelecom sh.a, sipas regjimit te autorizimeve te pergjithshme ne perputhje me Ligjin nr. 9918, date 19.05.2008, "Per komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" jane sherbimet e komunikimeve elektronike ne vijim:

1. Ofrimi i rrjetit publik telefonik fiks
2. Ofrimi i rrjetit publik per transmetim te dhenash/internet
3. Ofrim i sherbimit te telefonise publike fikse
4. Ofrimi i sherbimeve publike per transmetim te dhenash/internet
5. Ofrimi sherbimeve te linjave me qera
6. Sherbime te tranzitimit nderkombetar hyres/dales te trafikut (Carrier Nderkombetar)
7. Sherbime te radionderlidhjes bregdetare
8. Telegrafi

Albtelecom sh.a-se i eshte dhene liçenca e trete GSM nepermjet kompanise se re “Eagle Mobile”, ne te cilen Albtelecom zoteron 100 % te aksioneve.

Albtelecom zoteron rreth 90% te linjave te telefonise fikse ne Shqiperi. Pjesa tjeter zoterohet nga nje numer i madh operatoresh alternative te telefonise fikse. Numri i pajtimtareve te operatoreve te rrjeteve te telefonise fikse ne Shqiperi eshte ne nivele te uleta. Per vitin 2008 numri i pajtimtareve te operatoreve te rrjeteve telefonike fikse ishte rreth 320 mije, cka perben nje norme penetrimi prej 10% ne krahasim me 45% ne vendet e BE.

Tregu i sherbimeve celulare ka pasur rritje te ndjeshme vitet e fundit. Ne fund te vitit 2008, numri i perdoruesve celulare arriti ne afersisht 2,9 milion perdorues, qe perben nje norme penetrimi ne afersisht 92%. Eagle Mobile (qe zoterohet 100 % nga Albtelecom) filloi ofrimin e sherbimeve ne Mars 2008, dhe vleresohet te zoteroje rreth 10 % te numrit te perdoruesve celulare ne Shqiperi.

Bazuar ne VKM nr. 145, dated 11.02.2009, METE kerkon te shese aksionet e zoteruara nga shteti ne Albtelecom sh.a dhe po kerkon keshilltare per privatizimin, duke perfshire vleresimin e aksioneve, por jo e kufizuar vetem ne kete detyre.

## B. Qellimi i detyres

METE po kerkon nje keshilltar financiar , i cili do te punoje me METE per realizimin e procesit te privatizimit te paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime Albtelecom, bazuar ne Kerkesat Teknike dhe Detyrat Specifike (kapitulli C dhe D me poshte) :

## C. Kerkesat Teknike

Keshilltari i perzgjedhur duhet :

- Te jete nje kompani konsulente ose bashkim kompanish, me reputacion nderkombetar;
- Te kete eksperience ne asistimin e procedurave te privatizimit, duke perfshire edhe fushen e ekspertizes ligjore dhe financiare;
- Te kete eksperience ne vleresimin e bizneseve, veçanerisht ne sektorin e telekomunikacioneve;
- Te kete ekperience ne tregun nderkombetar te telekomunikacioneve ne pergjithesi.

## D. Detyrat Specifike

Konsulenti duhet te realizoje dy detyra kryesore :

A.- *Vleresimin e aksioneve te zoteruara nga shteti ne Albtelecom sh.a:*

Konsulentit i kerkohet te percaktoje vleren reale te tregut te 16,7683661 % te aksioneve te zakonshme te zoteruara nga shteti ne Albtelecom ne 31 Dhjetor 2008, per qellimet e transaksionit, duke marre parasysh te gjithe elementet qe zakonisht merren ne konsiderate ne vleresime te tilla, por jo e kufizuar vetem ne vleresimin e aksioneve.

a) Kapitali i Albtelecom sh.a;
b) Pasqyrat financiare te parashikuara (per pese vitet e fundit) dhe pasqyrat financiare historike te Albtelecom (bilancet, llogarite humbje – fitime, cash flow, dividenti), tatimi financiar;
c) Xhiroja dhe tregu i aksioneve i kompanise;
d) Kushtet ekonomike kombetare dhe te industrise;
e) Performanca historike, aktuale dhe e parashikushme e biznesit, pozicioni i tregut dhe tendencat e industrise.

Rezultati i vleresimit te konsulentit do te perfshihet ne nje raport qe do t'i paraqitet Ministrise. Ky raport do te perfshije analizat, menyrat e perdorura per vleresim, supozimet dhe te dhenat e perdorura per percaktimin e vleres.

B.- *Pergatitjen, realizimin e procedures se privatizimit dhe perfundimin e transaksionit :*

Konsulenti ne kendveshtrimin e legjislacionit shqiptar do te asistoje METE ne organizimin e procesit te privatizimit dhe konkretisht :

- Te kontribuoje ne pergatitjen e akteve nenligjore te nevojshme per procesin ;
- Te ndihmoje ne aktivitetin reklamues, botues dhe te marketingut per te terhequr investitoret e interesuar ;
- Te ndihmoje ne vleresimin e ofertave te paraqitura nga bleresit e mundshem;
- Te asistoje METE gjate negocimeve te kontrates per transferimin e aksioneve;
- Te asistoje METE per zgjidhjen e problemeve ligjore, financiare dhe ekonomike te shfaqura pas privatizimit te paketes prej 76 perqind.

Sherbimet e konsulences parashikohen te realizohen brenda kater muajve.

## E. Propozimi Teknik

Konsulenti parashikohet te jete nje kompani ose bashkim kompanish konsulente, qe kane nje eksperience perkatese pune ne keshillimin e korporates, vleresimin e biznesit dhe sektorin e telekomunikacionit.

Per te percaktuar aftesite dhe eksperiencen e kompanive te interesuara, informacioni i paraqitur duhet te perfshije :

a) emrin e kompanise, adresen, profilin,organizimin dhe stafin;
b) detaje te zyrave shqiptare te kompanise ose prezences ne Shqiperi, nese ka;
c) detaje te eksperiences se ndermarrjes se detyrave te ngjashme ne 5 (pese) vitet te meparshme, duke perfshire vendosjen dhe fokusimin ne rolin e kompanise ne vende te ngjashme te Europes Lindore;
d) CV e stafit qe mund te jete i mundshem te punoje ne detyre.

Ne rastin e konsorciumeve ndermjet dy ose me shume kompanive, informacioni per pikat a) deri d) me siper duhet te jepet ne lidhje me gjithe kompanite dhe drejtuesi i konsorciumit duhet te identifikohet qartesisht.

## F. Propozimi Financiar

Propozimi Financiar duhet te paraqitet ne nje zarf te veçante, te vulosur ne nje vend te dukshem. Ai duhet te perfshije nje vlere fikse per realizimin e detyres.

Buxheti maksimal i vlefshem per realizimin e sherbimeve eshte 25 milion leke, pa perfshire TVSH. Per shmangjen e dyshimeve, buxheti maksimal i disponueshem perjashton gjithashtu shpenzimet qe lidhen me perfundimin e procesit te privatizimit, te tilla si publikimi. Keto shpenzime do te mbulohen nga METE.

Ndonje Kandidat i Mundshem duhet te deklaroje se nuk ka dijeni per ndonje konflikt interesi apo konflikt te mundshem interesi, qe vjen si pasoje e kontratave apo marredhenieve te meparshme ose ekzistuese, te cilat mund te ndikojne materialisht ne aftesite e tij per pjesemarrje ne projekt.

## G. Konsulenca

Per te siguruar informacionin e dores se pare dhe njohurite paraprake per projektin dhe kushtet lokale, eshte e keshillueshme qe perfaqesuesi i kompanise konsulente te vizitoje Shqiperine.

Marreveshjet per vizitat e tyre do te jene nepermjet kontaktimit me Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimeve Tregtare ne adresen ne vijim :

Republika e Shqiperise
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve Tregtare
Engjell Qorlaze – Drejtoria e Privatizimit,

E-mail : eqorlaze@mete.gov.al
Tel: +++355 42 228467/74304

## Shtojca 18

### KERKESAT PER PERSONELIN KRYESOR

- Stafi i personelit qe do te merren direkt me realizimin e ketij sherbimi, duhet te kete nje eksperience pune jo me pak se 5 vjet.
- Stafi i cili do te merret me realizimin direkt e ketij sherbimi, duhet te kete ne perberje te tij persona te cilet te jene diplomuar ne fushen e ekonomise, drejtesise dhe telekomunikacioneve;
- Kontraktuesi duhet te paraqese listen e personelit qe do te merret direkt me realizimin e sherbimit te konsulences, duke paraqitur CV me fotografi.
- Ne perberje te stafit qe do te merret me realizimin direkt te ketij sherbimi, duhet te kete specialiste te cilet te kene eksperience:
  - ne asistimin e procedurave te privatizimit, duke perfshire edhe fushen e ekspertizes ligjore dhe financiare;
  - ne vleresimin e bizneseve, veçanerisht ne sektorin e telekomunikacioneve;
  - ne tregun nderkombetar te telekomunikacioneve ne pergjithesi.
- Kontraktuesi duhet te siguroje aprovimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktor, perpara heqjes ose zevendesimit te personelit kryesor.
- Kontraktuesi do te zevendesoje cdo punonjes, nese Autoriteti Kontraktor zbulon se personi ka kryer veprime te jashteligjshme, apo bie ne kundeshtim me kerkesat e Bleresit Publik te dhena ne dokumentat e tenderit, ose Autoriteti Kontraktor eshte mjaft i pakenaqur nga puna e personit.
- Nese behet e nevojshme te zevendesohet ndonje nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet te siguroje si zevendesues nje person me kualifikime ekuivalente ose me te mira.

Shtojca 19

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

**Të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik të zhvilluar në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor_______________ me objekt ____________ me fond limit __________**

**Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.**

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasuriven, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim

të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.**

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik ________________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**___________________________**